

ARGUMENTUM

news opinion analysis



**Koha për bisedime
për Paqe është Tani!**

-Kongresi i 20-të Kombëtar i
PKK-së: Kina harton të ardhmen
e modernizimit socialist

-Pse-të dhe e ardhmja
e Komunitetit Politik
European Post – Pragë!

- Europarlamenti të japë
i pari shembullin!

Të dashur lexues dhe ndjekës të Argumentum.al,

Argumentum.al tashmë nga muaji prill 2022 vjen në versionin e një reviste të përmuajshme politike-diplomatike të cilën mund ta shfletoni online. Ky botim mujor ofron një kombinim të qartë të lajmeve në vend, rajon dhe botë, si dhe opinioneve dhe analizave për ngjarjet e zhvilluara përgjatë një muaji. Duke falënderuar secilin prej jush për vëmendjen dhe besimin ndaj medias tonë, ju premtojmë që do të vijojmë të sjellim për ju analizat objektive mbi zhvillimet kryesore në Vend, Rajon, Europë dhe në Botë.

Argumentum.al përpaket të jetë burim autoritar i gazetarisë me analiza dhe komente mbi marrëdhëniet ndërkombëtare,

politikën botërore dhe një gamë të gjerë çështjesh me rëndësi globale duke sjelle materiale ekskluzive. Kjo falë edhe kontributit të disa prej emrave të njohur të politikës dhe publicistikës shqiptare dhe bashkëpunorëve të tjerë vendas dhe të huaj. Në të njëjtën kohë Argumentum.al është e hapur për komente e mendime të lexuesve të saj. Lexoni falas mbi çështjet e brendshme dhe ndërkombëtare në revisten Argumentum.al në shqip dhe anglisht!

“Argumentum”, një proces intelektual ...

Marjana DODA
Kryeredaktore

Përmbajtja

03 EDITORIAL

- Europarlamenti të japë i pari shembullin!
- Koha për bisedime për Paqe është Tani!

08 OPED

- Pse-të dhe e ardhmja e Komunitetit Politik European Post – Pragë!

12 JO VETËM LAJM

- Kongresi i 20-të Kombëtar i PKK-së: Kina harton të ardhmen e modernizimit socialist

14 REALPOLITIK

- Dialogu strategjik pa Ramën! Tur zyrtar apo qokë rajonale? Ec e ja e dialog s'ka! Avari e rëndë në “motorrin “BE-së! “Kurbanë” VIP të Brexit!

16 FOKUS

- Partneritet strategjik me SHBA-në/ Shqipëria aleat i besueshëm e pikë referimi në rajon
- Opozita dhe maxhoranca bashkojnë votat pro ndryshimeve në ligjin për okumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit

18 RAJONI

- Albin Kurti lë në fuqi vendimin për targat por me disa ndryshime. Ned Price: Shtetet e Bashkuara janë të zhgënjyera
- Pahor- Gjokanoviç “përplasen” për Ballkanin e Hapur:

Një iniciativë e evropianëve të zhgënjyer, surprizuese kjo dashuri e papritur mes Beogradit dhe Tiranës
- Gazsjellësi bullgar hap portat drejt Maqedonisë për furnizim të qëndrueshëm me gaz natyror

ENGLISH EDITION

23 EDITOR'S NOTE

- As Rama ridicules wickedly Albanians on energy price opposition caught in

24 REALPOLITIK

- Political club or community? A bad joke! From Harram to hallall! Helpful or harmful? Few carrots, many sticks”!

26 IN FOKUS

- US disappointed with Kosovo government for not postponing deadline of decision on Serb license plates in North
- Albania's PM Rama defends Serb President Vucic saying his 'friend' should be saved from Putin

28 TOP NEWS

- EC President says Albanian economy has got powerful after COVID19

29 BALKAN OVERVIEW

- Berlin Process back in action; Germany's Baerbock hails West Balkan free-movement initiatives

Europarlamenti të japë i pari shembullin!

Po flitet, shkruhet dhe diskutohet me të drejtë shumë mbi përballimin e krizës së pashembullt energjitike këtë dimër dhe në përgjithësi për ndryshimet klimatike, ngrohjen globale, etj. Gjithandej skenarë katastrofikë, rritje stratosferike çmimesh të gazit dhe energjisë elektrike, parashikime për ndërprerje furnizimi dhe dritash dhe plot të papritura të tjera të pakëndshme.

Bashkimi European, ndërkohë, po ndërmerr dhe po vendos masa radikale për kursimin e energjisë dhe kompesimin e rritjes së tarifave, sidomos për shtresat në nevojë.

Mirëpo, këtu, është momenti që ai të shmangë maksimën” Bëni si them unë, por mos bëni si bëj unë”! Institucionet e BE-së dhe në radhë të parë Parlamenti European, si tribuna më e madhe publike e 27 vendeve të saj duhet të jenë të parat me shembullin e tyre në trajtimin dhe lehtësimin e këtij shqetësimi.

Pikërisht këtu ka lindur problemi me Parlamentin European. Qysh nga viti 1992, me një konsensus të vendeve antare, ai ka dy seli – një në Bruksel dhe një tjetër në Strasburg. Në fakt, në këtë të fundit zhvillohen pothuajse të gjitha seancat plenare dhe ato të komisioneve të ndryshme. Për pasojë, fatura e shpenzimeve vjetore për mbajtjen dhe mbarëvajtjen e të dy godinave të tij gjigande, të transportit Brukel – Strasburg dhe brenda tyre të 5000 Eurodeputetëve dhe stafeve të tyre me administratën është pak të thuhet”e kripur”. Ajo llogaritet në 114 Milion Euro!!!

Mirëpo, për shkak të refuzimit të Francës, “Cirku i ec e jakeve” të tij, siç njihet në gjuhën popullore vazhdon. Kjo mbasi edhe Strasburgu konsiderohet si kryeqyteti simbolik i Europës në kuadrin e pajtimit të madh franko-gjerman dhe bashkimit european. Ndonëse, për këtë arsye atje u vendos më 1949 Këshilli i Europës dhe Gjykata Europiane e Strasburgut. Gjithsesi, përfitimet ekonomike prej KiE-së e cila mblidhet vetëm 4 herë në vit (hotele, restorante, muze, transporti brenda qytetit, etj) janë shumë të vogla krahasuar me ato të pranisë së



eurodeputetëve gjatë gjithë vitit.

Mirëpo, kriza e paparë energjitike e këtij viti e” ka mbushur kupën plot”! Ajo ka nxitur shumë deputetë të Bundestagut gjerman dhe të Europarlamentit të dalin publikisht këto ditë me kërkesën ultimative që të paktën këtë dimër, Parlamenti European” të bëjë një pauzë” dhe t’i zhvillojë punimet në të gjitha format dhe formatet vetëm në Bruksel. Kjo do të kursente sasi të mëdha energjie dhe gazi që shpenzohet në godinën e tij madhështore me një sipërfaqe 660.000 metra katrore në Strasburg. Po ashtu, do të shmangej konsumi i 19.000 ton dioksid karboni që ndot mjedisin si dhe shpenzimet mar-tramendëse për avion, hoteleri, ushqim, etj të 785 eurodeputetëve, 4.000 pjestarëve të stafeve të tyre dhe administratës së tij.

Kësisoj, Parlamenti European do të jepte dhe vetë një shembull konkret domethënës dhe jo vetëm leksione dhe shkurtime fondesh për të tjerët!.

Le të shpresojmë se këtë radhë do të dëgjohej ky zë dhe kjo kërkesë mëse legjitime e lartpërmendur, për sezonin e këtij dimri, por pse jo dhe për më tej!

Koha për bisedime për Paqe është Tani!



NGA MARJANA DODA

Dekada e dytë e shekullit XXI hyri dhunshëm në jetët tona.

Që nga viti 2020 e më tej secili prej nesh është dëshmitarë i disa ngjarjeve shënjuese për historinë e njerëzimit. Në fillim ishte Pandemia Covid-19, e cila u krahasua me gripin spanjoll të një shekulli më parë dhe që mori shumë jetë njerëzish në mbarë botën.

Askush nuk ishte imunë përballë këtij virusi të padukshëm që

kushtëzoi jetët tona.

Për shkak të shtrirjes globale dhe numrit të madh të njerëzve që

humbën jetën mendova se kjo ishte “Lufta e Tretë Botërore” pasi në të vërtetë, ishte një luftë!

Presidenti rus, Vladimir Putin

“Rusia është gati të rifillojë negociatat me Ukrainën, por nuk do të diskutojë zgjedhjen e banorëve të rajoneve Donbass, Zaporozhye dhe Kherson: ata janë bërë rusë një herë e përgjithmonë.”

Por ndërsa dalëngadalë po fillojmë të merrnim frymë nga këto dy vite sflitëse, një luftë e nxehtë trokiti në dyert e Europës. Një luftë e cila po përshkallëzohet çdo ditë e më shumë duke u kthyer në një kërcënim për secilin prej nesh.

Në fakt ndërsa në librat historike kemi lexuar e mësuar aq shumë për Luftën e Parë dhe të Dytë Botërore, nuk e kisha menduar kurrë se një ditë do të shkruaja për rrezikun real që i kanoset sot njerëzimit...për Luftën e Tretë Botërore.

Por, historia përsëritet!

Jemi përballë faktit. Rusia ndërhyri ushtarakisht në Ukrainë, më 24 shkurt të këtij viti. Një akt që dhunon çdo ligj ndërkombëtar, dhe që sot ka vënë në alarm botën mbarë.

Ndonëse Presidenti rus, Vladimir Putin përpara çdo veprimi në lidhje me Ukrainën na ka paralajmëruar nëpërmjet fjalimeve të tij, liderët botëror duket se i kanë injoruar ato.

Kujtojmë se pak ditë para 24 shkurtit, ai njohu zyrtarisht “pavarësinë” e dy qarqeve ukrainase, Donetsk dhe Luhansk, të cilat Rusia i kishte pushtuar pjesërisht që nga viti 2014 dhe tha se do bënte gjithçka për të mbrojtur popullsinë ruse në këto rajone.

Më pas, në orët e para të mëngjesit se 24 shkurtit 2022, u zgjuam nga lajmet se Rusia sulmoi Ukrainën me justifikimin se do të “denazifikonte” këtë vend.

Më 30 shtator ai firmosi dekretin, duke njohur dy rajone të tjera ukrainase, Kherson dhe Zaporizhzhia, si “të pavarura”, dhe më pas i shoqëroi me një fjalim të madh para kombit rus por që

Me aneksimin e 4 rajoneve e cila vjen shtatë muaj pas pushtimit të Moskës ndaj Ukrainës, duhet të përmbillet i ashtuquajti “Operacioni Special” i Rosisë në Ukrainë edhe si një “trofe” i kësaj lufte. Kjo është një mundësi që Rusia të tërhiqet me justifikimin se e ka përmbushur me sukses ndërhyrjen ushtarake.

i drejtohej njëkohësisht mbarë botës. Një fjalim paralajmërues për hapat e mëtejshëm që mund të ndërmerret Rusia.

Pasi deklaroi rezultatet e referendumeve në Luhansk, Donetsk, Kherson dhe Zaporizhzhia, Kremli organizoi një tubim për aneksimin e 15% të territoreve të Ukrainës.

Duke patur parasysh fjalimin e Putinit para mbështetësve duket se ishte edhe si një tubim ndaj pjesës tjetër të popullit rus që janë kundër luftës.

“Rusia jo vetëm që hap dyert e shtëpisë së saj të lindjes për vëllezërit dhe motrat – ajo hap zemrën e saj për ta. Mirë se vini në shtëpi!” – tha lideri rus.

Putin theksoi se tani Republikave të rajoneve Donbass, Kherson dhe Zaporozhye u është dhënë e drejta për të zgjedhur dhe vendosur.

Dhe njerëzit zgjedhën atdheun e tyre historik, ata bënë zgjedhjen të ishin me Rusinë.

Rusia nuk do të lejojë më kurër diktimitin perëndimor. Rrugat është zgjedhur. Po kthehemi te rrënjët, duke zgjedhur rrugën e

Perandorisë, ku të gjithë do të kenë mbrojtje.

Sigurisht fjalim i mbushur me retorikë intensive mbi historinë perandorake duket se është mjeti i vetëm për të justifikuar veprimet e tij dhe për të siguruar mbështetjen e popullit rus.


Por ky fjalim i presidentit rus në Kremlin nuk është vetëm për Donbasin dhe Ukrainën.

Kjo do të thotë se lufta sapo ka filluar...dhe nuk është ajo çfarë ne kemi parë deri më tani përgjatë këtyre shtatë muajve.

Ndaj duhen bërë çdo përpjekje duke lënë pas çdo retorikë lufte, kërkesë për armatime, duke i zëvendësuar vetëm me thirrje për Paqe përpara se të jetë shumë vonë.

Me aneksimin e 4 rajoneve e cila vjen shtatë muaj pas pushtimit të Moskës ndaj Ukrainës, duhet të përmbillet i ashtuquajti “Operacioni Special” i Rosisë në Ukrainë edhe si një “trofe” i kësaj lufte.

Kjo është një mundësi që Rusia të tërhiqet me justifikimin se e ka përmbushur me sukses ndërhyrjen



jen ushtarake.

Vijimi i mëtutjeshëm i retorikes së luftës jo vetëm nëpërmjet deklaratave të liderëve nga Rusia, SHBA e Ukrainë por dhe nëpërmjet akteve ushtarake që vijojnë intensivisht ndaj Ukrainës, do të thotë se po shkojmë drejt një Luftë të Madhe.

Dekreti për mobilizimin e pjesshëm në Rusi është një këmbane alarmi për Putin por edhe për çdo lider në çdo shtet të botës pasi askush nuk e do luftën dhe sot në shek XXI nuk ka asnjë arsye që të luftojmë kundër njëri-tjetrit.

Megjithatë është një shenjë e mirë që lideri rus bëri me pranimin e gabimit në thirrjen për mobilizimin e popullsisë.

Kjo do të thotë shumë për një lider si Putin...pranimi i një gabimi, ndaj një hap mbrapa do të mbetet sërish vlerë e tij.

Ndonëse historia dhe koha do ti japë vlerësimin e merituar çdo kujt dhe vetë Vladimir Putin konkretisht.

Njëkohësisht një tjetër shenjë nga Vladimir Putin është fakti se ai flet për negociata me Ukrainën.

“Rusia është gati të rifillojë negociatat me Ukrainën, por nuk do të diskutojë zgjedhjen e banorëve të rajoneve Donbass, Zaporozhye dhe Kherson: ata janë bërë rusë një herë e përgjithmonë, theksoi Putin.

Por kjo thirrje nuk gjeti përkrahje nga pala tjetër pasi nga Kievi e hodhën poshtë këtë kusht duke thënë se do të negocionin për paqe por jo me Putinin si Presidenti rus.

Po ashtu, po në të njëjtën ditë, menjëherë pas aneksimit nga Rusia të katër rajoneve ukrainase, Presidenti ukrainas Volodymyr Zelenskyy njoftoi aplikimin për anëtarësim në NATO me procedurë të përshpejtuar,

Përgjigjia e Liderit ukrainas duke firmosur aplikimin për antarësim të përshpejtuar në NATO nuk bën gjë tjetër, veçse rrezikon një luftë Rusi-Nato pra Luftën e Tretë Botërore.

Mos te harrojmë se pikërisht perspektiva e anëtarësimit në NATO ishte një nga arsyet që Putini pushtoi Ukrainën.

NATO, BE kanë patur 8 vite kohë për antarësimin e Ukrainës në mënyrë të përshpejtuar duke i garantuar asaj siguri por jo tani që jemi para një fakti të kryer.

Jo tani ku lideri rus dhe ai amerikan i drejojnë gishtin kërcënues njëri-tjetrit se do të mbrojnë me çdo kusht çdo centimentër të tokës ruse dhe çdo centimentër të tokës së aleatëve të Nato-s. E me çdo kusht do të thotë edhe me përdormin e armëve që shfarosin në masë.

Në shekullin XXI kam menduar se rreziku më i madh ndaj njerëzimit është ngrohja globale, ndryshimet klimaterike, apo të tjera rreziqe si pandemia apo fenomene të tjera natyrore qofshin tërmete, tsunami etj.

Të gjitha këto do duhet të ishin sot pjesë kryesore e agjendës së liderëve botëror dhe institucioneve ndërkombëtare.

Për të bërë gjithçka kundër rrezikut real para të cilit ndodhet sot mbarë njerëzimi.

Por kërcënimimi me lufte, me armë bërthamore apo me çdo armë tjetër, tregon se në krye të disa shteteve ekzistojnë armiqtë e Njerëzimit.

Kësisoj, thirrja për armatime në vend të thirrjes për paqe është shqetësuese, dëshpëruese dhe tejet zhgënjyese.

Nuk mund ta besoj që sot nuk ekzistojnë lider që të ulen në tryeze për të negociuar. Historia botërore ka treguar se në momente vendimtare kanë marrë vendime të guximshme pasi arsy-eja e Jetës prevalon mbi gjithçka.

Por përgjate gjithë këtyre muajve kërkesat e vetme janë për armë... armatime, duke shpalosur para mediave shifra të armiqve të të rënëve (deri dje ishin vëllezër) me idenë se vetëm kështu mund ta mposhtin Rusinë.

Vertetë z. Zelensky, e besoni këtë që thoni?

Mund ta mposhtë Ukraina, Rusinë?

Sigurisht, Ukraina ka motiv për të luftuar sepse është cënuar ushtarakisht...ka armatime për të luftuar sepse vendet aleatë të Nato-s dhe jo vetem por çdo vend tjetër në botë ka dërguar armatime, dhe ndihma të tjera humanitare, por deri kur?

Deri sa Rusia të përplaset drejt-përdrejtë me NATO-n?

Pastaj... asnjë analizë, asnjë mendim asnjë fjalë nuk ka më vlerë. Sepse ndoshta shumë prej nesh nuk do ekzistojnë.

Do ti rikthehem shifrave, qofshin këto nga Ukraina apo Rusia që tregojnë me mburrje numrin e të rënëve të armikut.

Jo vetëm jo njerëzore por jo realiste.

Nga njera anë flitet për një Rusi të dobët ushtarakisht, pavarësisht se për dekada me radhe Perëndimi e ka quajtur si kërcënim për të.

Ndërsa nga ana tjetër kemi një Ukrainë të fortë që po e zmbra-
Rusinë(!)

Thjeshtë Propagandë!

Nuk flitet aspak për mijëra refugjatë ukrainas që janë rrugëve të Europës. Nuk flasim për gjendjen e tyre, kushtet e tyre, ndonëse janë ndër refugjatët më të "privilegjuar" në këto 30 vite por sërish ata po përballen me betejat për mbijetesë.

Nuk flasim për ata qindra fëmijë të zhdukur, vajza e gra të dhunuara. Nuk flitet për trafikimin e vajzave ukrainase...raste të cilat janë me qindra e mijëra dhe që ndodhin në çdo moment.

Nuk flitet për mijëra të rinj rus që i thonë jo luftës qofshin duke dezertuar nga kazermat ushtarake, qofshin ata që javët e fundit po arratisen nga vendi i tyre pas thirrjes për mobilizim të pjesshëm të popullsisë.

Kush po i mbron këta njerëz?

Dhe flasim për fitore...?

E në fakt kjo luftë në dyert e Europës në shekullin XXI tregon humbjen më të madhe që Rusia, Ukraina po përballen, e bashkë me ta rrezikojmë të humbasim të gjithë ne.

Askush nuk e do luftën...askush nuk i gëzohet fitores së saj qofshin dhe me disa numra më shumë ose më pak të atyre që humbin jetën pikërisht në luftë.

Nëse 7 muaj më parë ishim përpara të disa situatave të panjohura, të pallogaritshme, gati-gati përballë një situatë surreale, sot gjithçka është e qartë. Jemi në Luftë! Jemi në një luftë që po përshkallëzohet me shpejtësi, andaj duhet të përgjigjemi tani para se të jetë vonë.

Negociata...negociata me çdo kusht, negociata me çdo çmim, pasi në emër të Paqes, në emër të Jetës në emër të ekzistencës së Njerëzimit ia vlen çdo sakrificë!

Nëse 7 muaj më parë ishim përpara të disa situatave të panjohura, të pallogaritshme, gati-gati përballë një situatë surreale, sot gjithçka është e qartë. Jemi në Luftë! Jemi në një luftë që po përshkallëzohet me shpejtësi, andaj duhet të përgjigjemi tani para se të jetë vonë.

Pse-të dhe e ardhmja e Komunitetit Politik European Post – Pragë!



DR. JORGJI KOTE *MJESHTËR I MADH*

EKSKLUZIVISHT PËR ARGUMENTUM

Dje, më 6 Tetor u inaugurua në Samitin e Pragës Komuniteti Politik European (KPE) me praninë e liderëve nga 27 vendet e BE-së bashkë me 17 shtete kandidate dhe jo antare por partnere të ngushta.

Dihet se idenë për krijimin e KPE-së e hodhi Presidenti francez Macron më 9 Maj në Seancën Plenare të Parlamentit European në Strasburg, e cila u konfirmua më e specifikuar në Samitin e BE-së me 24 Qershor në Bruksel.

Duke iu referuar burimeve zyr-

tare, ky Grupim i ri european është një platformë “për nxitjen e dialogut dhe bashkëpunimit politik në trajtimin e çështjeve me interes të përbashkët dhe

forcimin e sigurisë, stabilitetit dhe begatisë në kontinent”. Ky Samit i parë u kufizua të çështjet më kritike të sotme – paqja, siguria, klima, kriza energjitike dhe

“

Kriza e koronës dhe veçanërisht agresioni rus ndaj Ukrainës dëshmoi se BE-ja me 27 vende antare e ka të pamundur të luajë e vetme rolin e saj gjeopolitik në skenën europiane dhe më gjerë. Ajo nuk ka lëvizur pothuajse asnjë cm pas cilësimit epik të ish Ministrit të Jashtëm belg Mark Eyskens më 1991 se “BE-ja është gjigand ekonomik, xhuxhmaxhuxh politik dhe krimb ushtarak”. Në 10 vitet e fundit ajo ka dështuar në politikat e saj të fqinjësisë dhe në Ballkan, duke qenë “zjarrfikëse” por jo menaxhuese.

situata ekonomike.

Debatet, diskutimet, hamendësimet, rezervat dhe dyshimet mbi KPE-në, arsyet dhe motivet e vërteta të krijimit, të ardhmen dhe rrjedhojat e pritshme në politikën europiane dhe më gjerë kanë qenë në qendër të vëmendjes së politikës dhe medias ndërkombtare gjatë këtyre muajve të fundit.

Një ndër shqetësimet kryesore, sidomos në Ballkanin Perendimor kishte të bënte me drojën dhe dyshimet për dobësimin, ngadalësimin e deri në heqjen fare të Zgjerimit të mëtejshëm European nga axhenda e BE-së; madje, deri aty sa forumet europiane dhe rajonale të dy viteve të fundit Zgjerimi qoftë dhe si term në dokumentat e BE-së “shpëtoi” vetëm falë kompromiseve të çasteve të fundit. Dyshimet i shtoi më tepër Strategjia e Zgjerimit 2020, e cila nuk përcakton afate konkrete për antarësimin e vendeve të rajonit tonë. Ndërkohë, po zvarritej çelja e negociatave me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut. Ndërkohë, procedurat e tjera, sidomos shtimi i kontrollit të vendeve antare në çdo etapë të procesit, praktikisht dukej se e shtynin në kalendrat greke antarësimin e Ballkanit Perendimor në BE.

Në fakt, ky shqetësim nuk ishte pa baza; ai i referohej idesë së krijimit të një “Europe me dy shpejtësi/korsi” që qarkullonte deri vonë dhe asaj me “tri rathë koncentrikë”, të cilën Presidenti Macron e kishte artikuluar në ligjëratën e tij në Universitetin e Lisbonës më 27 Korrik 2018.

Dyshimi tjetër ishte se nëpërm-



*Një ndër shqetësimet kryesore, sidomos në **Ballkanin Perendimor** kishte të bënte me drojën dhe dyshimet për dobësimin, ngadalësimin e deri në heqjen fare të Zgjerimit të mëtejshëm European nga axhenda e BE-së; madje, deri aty sa forumet europiane dhe rajonale të dy viteve të fundit Zgjerimi qoftë dhe si term në dokumentat e BE-së “shpëtoi” vetëm falë kompromiseve të çasteve të fundit. Dyshimet i shtoi më tepër Strategjia e Zgjerimit 2020, e cila nuk përcakton afate konkrete për antarësimin e vendeve të rajonit tonë. Ndërkohë, po zvarritej çelja e negociatave me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut.*



jet këtij forumi, Brukseli, Franca dhe Gjermania synojnë të realizojnë hegjemoninë e tyre në Europë; ndryshe, sipas skeptikëve, përse është e nevojshme KPE-ja, kur kemi KiE-në dhe OSBE-në?

Gjithsesi, shumë gjëra duket se tani janë sqaruar dhe sheshuar. Për më tepër, axhenda e lehtë, informale, takimet dypalëshe, mungesa e një deklarate ose Komunikate nga Samiti i Pragës, sidomos fakti që takimi i ardhshëm do të zhvillohet në Moldavi, pastaj në Madrid dhe në Londër, duke alternuar kështu vendet antare me jo antare të BE-së, mbi të gjitha agresioni rus dhe rezistenca heroike ukrainase kanë qetësuar “shpirtrat e trazuar”.

Ndaj, tani le të ndalemi në “psetë” kryesore që e bëjnë të nevojshëm këtë konstruksion të ri Politik European dhe të ardh-

men e tij, bashkë me aktorët/faktorët përkatës.

Së pari, kriza e koronës dhe veçanërisht agresioni rus ndaj Ukrainës dëshmoi se BE-ja me 27 vende antare e ka të pamundur të luajë e vetme rolin e saj gjeopolitik në skenën europiane dhe më gjerë. Ajo nuk ka lëvizur pothuajse asnjë cm pas cilësimit epik të ish Ministrit të Jashtëm belg Mark Eyskens më 1991 se “BE-ja është gjigand ekonomik, xhuxhmaxhuxh politik dhe krimb ushtarak”. Në 10 vitet e fundit ajo ka dështuar në politikat e saj të fqinjësisë dhe në Ballkan, duke qenë “zjarrfikëse” por jo menaxhuese.

Ndikim negativ të veçantë ka patur largimi i Britanisë së Madhe, grindjet/debatet e brendshme për “ribërjen e BE-së” dhe dukuri të tjera negative.

Veç kësaj, rolin e saj në Europë dhe më gjerë po e kërcënojnë alternativat ruso-kineze, si Bashkimi Euro-Aziatik, apo BRIC (Brazil, Rusia, India dhe Kina)

Ja pse, për realizimin e objektivave të saj gjeopolitike, BE-ja ka nevojë të ngutshme për zgjerim dhe kohezion politik me vende të mëdha fqinje dhe shtete të tjera të fuqishme, sidomos Britaninë e Madhe, Turqinë dhe aktualisht Ukrainën. Veç rolit lider britanik në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, Turqia ka patur ndikim madhor në frenimin e valëve masive të azilit nga Afrika, duke strehuar për vite me radhë rreth 4 milion refugjatë. Marrëveshja me të ishte shpëtimtare për politikën e kompromentuar të azilit të BE-së; edhe pse i duhet të paguajë një çmim të lartë, duke mos “bërë potenciale” për shkeljen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore.

Së dyti, në kuadrin e krijimit të një fronti të gjerë të shteteve demokratike, KPE-ja synon të bashkojë shumë vende, të cilat nuk synojnë antarësimin në BE, si Norvegjia, Islanda, Zvicra, ose e kanë të pamundur këtë antarësim brenda një afati të shpejtë kohor; tipik është rasti i Ukrainës dhe i Ballkanit Perendimor, ku statusi “kandidat” dhe negociatat e antarësimit janë të pamjaftueshme dhe “nuk ngopin”.

Mirëpo, nuk është e drejtë që këto vende aleate tradicionale të BE-së dhe me potenciale të mëdha në fushat e ekonomisë, të sigurisë dhe të mbrojtjes, të lihen “në plan të dytë e të tretë”, mbasi kjo do të zbehte ndjeshëm efektivitetin e veprimit politik të BE-së dhe pritshmëritë e saj

gjeopolitike.

Së treti, shmangia përfundimtare e ndërhyrjeve dhe rrezikut rus e kinez, sidomos në vendet me sisteme të pakonsoliduara politike dhe ekonomike, në Ballkan dhe gjetkë është kthyer në një përparësi absolute gjeostrategjike. Për rrjedhojë, duke i afruar dhe më shumë këto vende në KPE, BE-ja shuan ose zbut kritikën dhe qortimet për lënien e tyre pasdore përballë rreziqeve të mësipërme.

Së katërti, vërtet që në Europë dhe më gjerë operojnë KiE-ja dhe OSBE-ja, mirëpo përvoja e viteve të fundit tregon se roli dhe

Në kuadrin e krijimit të një fronti të gjerë të shteteve demokratike, KPE-ja synon të bashkojë shumë vende, të cilat nuk synojnë antarësimin në BE, si Norvegjia, Islanda, Zvicra, ose e kanë të pamundur këtë antarësim brenda një afati të shpejtë kohor; tipik është rasti i Ukrainës dhe i Ballkanit Perendimor, ku statusi “kandidat” dhe negociatat e antarësimit janë të pamjaftueshme dhe “nuk ngopin”.

ndikimi i tyre lidhur me kohezionin politik dhe institucional është gërryer sa nuk ka më për shkak të Rosisë dhe Bjellorisë; në fakt, ato dinë dhe duan vetëm të bllokojnë gjithçka atje dhe në OKB, në kundërshtim të hapur me parimet dhe normat e të drejtës ndërkombëtare. Ndaj ato nuk do të jenë në KPE, e cila është bashkim i vendeve me vlera dhe parime të përbashkëta demokratike dhe perendimore.

Së pesti, tashmë është bërë e qartë se KPE-ja nuk do të zëvendësojë procesin e zgjerimit dhe as nuk do të jetë shkas për ngadalësimin e ritmeve të tij. Përkundrazi, falë marrëdhënieve, nismave dhe mundësive politike që do të krijohen brenda tij, KPE-ja do të sugjerojë lehtësimin dhe përshpejtimin e procesit të zgjerimit dhe promovimin e programeve shtesë të ndihmave të BE-së.

Por, le ta theksojmë se përparimi në këtë drejtim do të jetë kryesisht në vartësi të ecurisë së vendeve kandidate në procesin e reformave demokratike dhe arritjeve të brendshme. Ndaj, të mos e gënjejë njeri mendja se KPE-ja do të jetë alternativë, zëvendësues ose kompensues i Strategjisë së Zgjerimit, aq më pak i retorikave dhe dështimeve tona me reformat dhe në procesin e negociatave të antarësimit.

Së gjashti, KPE-ja do të jetë “pronë” e të gjithëve, pa dallim e diskriminim, pavarësisht nga madhësia gjeografike, popullsia, pesha ekonomike, etj.

Sa për pyetjen përse e lançoi Macron dhe Franca idenë e KPE-së, vetëkuptohet se si bashkëthemelues të BE-së, falë peshës gjeopolitike dhe kontributit të



tyre të gjithanshëm, Franca dhe Gjermania janë dhe do të mbeten boshti i pazëvendësueshëm i BE-së. Asnjë vend tjetër i madh përendimor nuk i ka kapacitetet, konsensusin, përvojën dhe rolin e tyre historik në Europë dhe më gjerë. Pastaj, nëse këtë nismë do ta shpaloste një vend më i vogël, do të thuhej, po pse te ai mbeti kjo nismë e madhe, ai mbeti për të na mësuar, ose do të quhej si “satelit” i ndonjë vendi të madh. Ndaj, është më e udhës të gjykohej se sa ia vlen një ide apo nismë politike, sidomos kur lançohet nga një vend me rezonancë planetare si Franca mbi baza gjithëpërfshirëse.

Deri tani përmendëm aspektet pozitive dhe avantazhet, por funksionimi i KPE-së nuk përjashton dhe të kundërtën, dmth problemet, sherrnajat, kthimin e tij në një tribunë kundër BE-së, vendeve dhe vendimeve të tij të veçanta. KPE-ja nuk ka asnjë imunitet prej këtyre dukurive të këqia që kan kapluar BE-në, NATO-n etj.

Së fundi, në fakt, siç dhe ishte paralamëruar, nga Samiti inaugurues në Pragë nuk pritej ndonjë gjë konkrete, veç frymës, dhe

klimes pozitive premtuese. Në fakt, puna e vërtetë fillon tani me përgatitje dhe hapa intensive për strukturimin, përcaktimin e misionit dhe procedurat e antarësimit të tij; këto të fundit do të mbështeten mbi parimin e “soft – laë” ose “e drejta e butë” çka nënkupton jo kritere të rrepta si ato të BE-së, jo të drejtë vetoje dhe shumicë të cilësuar votash; mbi të gjitha respektimin e standardeve demokratike dhe shtetit të së drejtës.

Këto dhe të tjera aspekte do të përcaktohen në Programin e KPE-së deri në vitin 2023, i cili do të jetë produkt i bashkëautorësisë së vendeve antare të BE-së me ato kandidate dhe jo – antare. Përpunimi dhe miratimi i tyre përfundimtar do të bëhet pas zgjedhjeve europiane të vitit 2024. Kjo do të krijojë hapësirë dhe kohë të bollshme, që mbi bazën e propozimeve që do të bëhen deri atëhere në KPE, edhe BE-ja nga ana e saj të bëjë ndryshimet e duhura në traktatet e saj themelore, të cilat parashikojnë heqjen e vetos dhe lejojnë shumicën e kualifikuar në aspektet e politikës së jashtme, të zgjerimit, etj.

Përfundimisht, ka shumë të ng-

jarë që nëse gjithçka ecën mirë dhe pa probleme, nëpërmjet KPE-së të krijohet një arkitekturë e re gjeopolitike në Europë, në bashkëpunim me SHBA-të, por me një autonomi cilësisht më të madhe. Ndonëse pak më lart u tha se tani për tani ajo nuk zëvendëson e as dublon ndonjë grupim tjetër europian, në të ardhmen e afërt KPE-ja mund të kthehet në një lloj OSBE-je të re, veçse tani pa Rusinë dhe Bjellorusinë, mbi bazën e një dokumenti vijues të ngjashëm me “Akti Final i Helsinkit” (1975) dhe “Karta e Parisit për një Europë të re” e Nëntorit 1990.

Së fundi, në kushtet e krizave të rënda që kanë mbërthyer kontinentin, të telasheve dhe halleve të përditshme të miliona qytetarëve europianë, jehona e KPE-së është në minimumet e veta. Por, vendimtare për të ardhmen dhe suksesin e saj do të jetë fitorja e Ukrainës mbi Rusinë, si triumfi i vlerave europiane mbi rregjimet totalitare dhe autoritare. Ajo do të krijojë një moment të ri epokal paqeje, miqësie dhe bashkëpunimi, pse jo dhe më entuziazte se atmosfera e krijuar pas ribashkimit gjerman dhe europian 32 vite më parë.

Kongresi i 20-të Kombëtar i PKK-së: Kina harton të ardhmen e modernizimit socialist



Kina ka vendosur synime, detyra dhe politika për kauzën e Partisë Komuniste të Kinës (PKK) dhe të vendit për pesë vitet e ardhshme e më tej, ndërsa PKK hapi Kongresin e saj të 20-të Kombëtar të dielën.

PKK ka siguruar arritje historike dhe ka parë ndryshime historike në kauzën e Partisë dhe të vendit gjatë dekadës së fundit, tha Xi Jinping, i cili dorëzoi një raport në kongres në emër të Komitetit Qendror të 19-të të PKK.

“Pesë vitet e ardhshme do të jenë vendimtare për fillimin e mirë të përpjekjeve për të ndërtuar një vend socialist modern në të gjitha aspektet,” tha ai.

‘Bëmat historike’ në dekadën e fundit

Duke parë 10 vitet e fundit, Xi tha se vendi ka arritur shumë

“bëma historike”.

“Ne përqafluam njëqindvjetorin e Partisë Komuniste të Kinës; ne futëm në një epokë të re të socializmit me karakteristika kineze dhe ne zhdukëm varfërinë absolute dhe përfunduam ndërtimin e një shoqërie mesatarisht të begatë në të gjitha aspektet, duke përfunduar kështu Qëllimin e Parë të Njëqindvjetorit,” tha ai, duke shtuar se ato ishin “bëma historike” që do të regjistrohen përgjithmonë në historinë e kombit kinez dhe do të ndikojnë thellësisht në botë.

Drejt “modernizimit kinez”

Duke shpjeguar detyrën qendrore të PKK-së në udhëtimin e ri përpara, Xi tha se PKK do ta udhëheqë popullin kinez në realizimin e Objektivit të Dytë të Njëqindvjeçarit dhe për të çuar përpara përtëritjen e kombit ki-

nez në të gjitha frontet përmes “një rrugës kineze drejt modernizimit”.

Kërkesat thelbësore të modernizimit kinez janë mbajtja e lidërshiptit të PKK dhe socializmit me karakteristika kineze, ndjekja e zhvillimit cilësor, zhvillimi i demokracisë popullore të gjithë procesit, pasurimi i jetës kulturore të njerëzve, arritja e prosperitetit të përbashkët për të gjithë, promovimi i harmonisë midis njerëzimit dhe natyrës, duke ndërtuar një komunitet njerëzor me një të ardhme të përbashkët dhe duke krijuar një formë të re të përparimit njerëzor, sipas Xi.

“Ai përmban elementë që janë të përbashkët për proceset e modernizimit të të gjitha vendeve, por karakterizohet më shumë nga tipare që janë unike për kontekstin kinez,” tha ai.

Për të ndërtuar një vend socialist modern në të gjitha aspektet, ai theksoi më tej disa aspekte kryesore, të tilla si krijimi i një modeli të ri zhvillimi dhe ndjekja e zhvillimit me cilësi të lartë, fuqizimi i Kinës përmes shkencës dhe arsimit dhe përmirësimi i mirëqenies së njerëzve.

“E ardhmja jonë është e ndritur, por ne kemi ende një rrugë të gjatë për të bërë,” tha Xi, duke i kërkuar Partisë që të përballë ballë për ballë me pengesat dhe vështirësitë, të sigurojë zhvillimin dhe sigurinë dhe të gërmojë thellë për të kapërcyer vështirësitë dhe sfidat në rrugë përpara.

Ribashkimi kombëtar: Tajvani është një çështje e kinezëve

Xi Jinping tha të dielën se Partia Komuniste e Kinës (PKK të zbatojë politikën e saj të përgjithshme për zgjidhjen e çështjes së Tajvanit në epokën e re dhe do të çojë në mënyrë të palëkundur kauzën e ribashkimit kombëtar.

“Zgjidhja e çështjes së Tajvanit është një çështje e kinezëve, një çështje që duhet të zgjidhet nga kinezët,” tha Xi në seancën hapëse të Kongresit të 20-të Kombëtar të PKK.

“Ne do të vazhdojmë të përpiqemi për ribashkim paqësor me sinqeritetin më të madh dhe përpjekjet maksimale, por nuk do të premtojmë kurrë se do të heqim dorë nga përdorimi i forcës dhe ne rezervojmë mundësinë e marrjes së të gjitha masave të nevojshme. Kjo është e drejtuar vetëm në ndërhyrjen e forcave të jashtme dhe pak separatistë që kërkojnë “pavarësinë e Tajvanit” dhe aktivitetet e tyre separatiste; ai nuk është aspak i synuar ndaj

PRESIDENTI KINEZ, XI JINPING

“Ne kemi treguar gjithmonë respekt dhe kujdes për bashkatdhetarët tanë nga Tajvani dhe kemi punuar për të sjellë përfitime për ta. Ne do të vazhdojmë të promovojmë shkëmbimet ekonomike dhe kulturore dhe bashkëpunimin nëpër ngushticat e Tajvanit,”

bashkatdhetarëve tanë tajvani,” tha ai.

Xi tha se rrotat e historisë po rrotullohen drejt ribashkimit të Kinës dhe përtëritjes së kombit kinez. “Ribashkimi i plotë i vendit tonë duhet të realizohet dhe pa dyshim që mund të realizohet!

“Ne kemi treguar gjithmonë respekt dhe kujdes për bashkatdhetarët tanë nga Tajvani dhe kemi punuar për të sjellë përfitime për ta. Ne do të vazhdojmë të promovojmë shkëmbimet ekonomike dhe kulturore dhe bashkëpunimin nëpër ngushticat e Tajvanit,” tha Xi.

“Ne do të inkurajojmë njerëzit në të dy anët e ngushticës së Tajvanit që të punojnë së bashku për të promovuar kulturën kineze dhe për të krijuar lidhje më të ngushta,” tha ai.

Rritja ekonomike

Kina ka parë një rritje historike në fuqinë e saj ekonomike në dekadën e fundit, tha Xi.

GDP-ja e Kinës është rritur në

114 trilion juanë (rreth 16 trilionë dollarë) nga 54 trilion juanë në dekadën e kaluar dhe përbën 18.5 për qind të ekonomisë botërore, me 7.2 pikë përqindjeje, tha ai.

Detyra qendrore e PKK-së

“Që nga kjo ditë e tutje, detyra qendrore e PKK do të jetë të udhëheqë popullin kinez të të gjitha grupeve etnike në një përpjekje të përbashkët për të realizuar qëllimin e dytë të njëqindvjeçarit për ndërtimin e Kinës në një vend të madh modern socialist në të gjitha aspektet dhe për të çuar përpara rinovimin. të kombit kinez në të gjitha frontet përmes një rruge kineze drejt modernizimit”, tha Xi teksa shpjegoi misionet dhe detyrat e PKK në udhëtimin e ri të epokës së re.

PKK synon të realizojë në thelb modernizimin socialist nga 2020 deri në 2035 dhe ta ndërtojë Kinën në një vend të madh modern socialist që është i begatë, i fortë, demokratik, i avancuar kulturalisht, harmonik dhe i bukur nga viti 2035 deri në mesin e këtij shekulli.

Dialogu strategjik pa Ramën! Tur zyrtar apo qokë rajonale? Ec e ja e dialog s'ka! Avari e rëndë në “motorrin” BE-së! “Kurbanë” VIPtë Brexit!

REALPOLITIK “FLASH” NO. 56

17 – 31 TETOR 2022

EKSKLUZIVISHT PER ARGUMENTUM

Shkurt dhe Shqip mbi 5 ngjarjet kryesore diplomatike me vetëm 1000 fjalë nga analisti i njohur diplomatik Dr. Jorgji KOTE

DR. JORGJI KOTE *MJESHTËR I MADH*

1. Dialogu strategjik pa Ramën u zhvillua më 25 Tetor në Uashington midis qeverisë shqiptare dhe asaj amerikane. Ndryshe nga forumet e tjera, ndonëse “strategjik” ai pati jehonë të vakët publike dhe mediatike. Njoftimet për shtyp ishin telegrafike; me formulime të përgjithshme të përsëritura; asnjë e re, pothuajse asgjë për demokracinë, korrupsionin, azilin e paligjshëm që po “bën kerdinë” dhe të këqia të tjera që na kanë pllakosur. Ra në sy mosprania e Kryeministrit Rama. E çuditshme kjo mungesë kur ai nuk le as takime komunash pa shkuar; ca më tepër, kur në dialogjet strategjike me Greqinë, Turqinë, etj kanë qenë të pranishëm Kryeministrat e tyre. Emri i tij nuk u përmend në njoftimet e shtypit dhe as në Deklaratën e Blinken. Të jenë shenja të ftohjes së përfolur me Ramën, pas” periudhës së gjatë të mjaltit? Sidomos kur veç Biden, nuk ngeli politikan pa prituri me bujë Veliaj disa javë më parë. Apo kjo ishte një” Jo” diplomatike për sjelljen politike, aferat dhe skandalet që Rama i quan suksese?

Gjithashtu, pak kohë më parë, Rama pati paralajmëruar se në



dokumentin strategjik do të shprehej fuqishëm mbështetja amerikane për Ballkanin e Hapur. Por ai nuk figuron askund. Normal, përderisa më 3 Nëntor në Berlin do të mbledhet Samiti i Procesit me të njëjtin emër, që do ta skualifikojë dhe çmontojë” Ballkanin e Hapur”! Sepse ai nuk solli asgjë të re, veç sherr dhe ndarje, madje” dhe mes vedi”

2. Tur zyrtar apo qokë rajonale? Kjo është pyetja që shtrohet pas vizitës zyrtare në Ballkanin Perëndimor të Presidentes së Komisionit European, Ursula Von der Leyen më 26 – 29 Tetor. Ky tur ishte në kuadrin e eventeve, samiteve dhe proceseve, që janë

pjesë e kthesës historikë të BE-së në rajon; ku” qershiza mbi tortë » do të jetë Samiti BE- Ballkani Perëndimor në Tiranë më 6 Dhjetor. Leyen pasoi turin e Presidentit të Këshillit European, Charles Michel dhe vizitat e para rajonale të Kancelarit gjerman Scholz, Presidentit italian Mattarella, kryeministrave të Finlandës, Hollandës dhe Luksemburgut.



Mirëpo, Leyen zhgënjeu, sepse nuk dha asnjë sinjal apo mesazh të ri, veç” avazit” të vjetër, evokimit të rrezikut rus, ndihmave për kapërcimin e krizës energjetike dhe elozheve për mikpritësit; ajo takoi dhe Presidentin e ri të Republikës Serpska Dodik,” non – grata” nga SHBA-të. Por, shumë

pak, për të mos thënë asgjë dëgjuam për demokracinë, azilin e paligjshëm alarmues, krimin e organizuar, skandalet... Vetëm fjalë të mira, gajret, elozhe dhe "Gjithçka OK" E pakuptueshme kur ky tur bëhej 10 ditë pas publikimit të Raportit të Komisionit të saj European, plot problematika shpërthyes. Si diplomat e di mirë se këto shqetësime janë përmendur në takimet me dyer të mbyllura. Gjithsesi, nisur nga serioziteti i situatës dhe kthesa historike që synon BE-ja, ia vlente të thuheshin, me gjuhë/eufemizma diplomatike, pra me "pambuk" dhe "lezet" disa fjalë kritike për qeverinë dhe pse jo inkurajuese për opozitën. Vetëm kështu ky tur zyrtar nuk do të katandisej në "qokë" rajonale.

3. "Ec e ja, e dialog s'ka!" Kjo mund të thuhet për vizitat e të Dërguarve të Posaçëm të BE-së dhe SHBA-ve, Lajçak dhe Eskobar në Beograd, Prishtinë dhe Bruksel gjatë këtyre dy javëve, me deklarime, paralajmërime dhe njoftime kontradiktore për modelin franko-gjerman. Por prapë, asgjë, dialogu ka ngecur në baltë, pa shenjë jete. Dhe nuk ka si të lëvizë përderisa SHBA dhe BE-ja vazhdojnë ta mbajnë naivisht « me hatër» Serbinë, pavarësisht trysnisë së tyre, e cila tani së fundi është rritur ndjeshëm. Fatkeqësisht, ato ende nuk po e kuptojnë se Beogradi dhe Vuçiç nuk ka shanse të ndryshojnë; ja, dhe qeveria e re serbe, asgjë të re, veç tanimë 4 ish ministrave të Milosevic-it dhe betimit "do ta mbajmë Kosovën dhe Metohinë brenda Serbisë"! Të tjerat janë llafe pa bërëqet, ose "fjalë të mira dhe gurë në trastë".



Tani gjithkush duhet te kuptojë se me Serbinë "nuk pi më ujë" diplomacia" e butë" (soft power) dhe me "ec e jake" (shuttle); as vetëm "me kulaç"! Me Beogradin është koka për "kërbaç" politik, "ama" o tani, o kurrë!"

4. Avari e rëndë në "motorrin" e BE-së ose në boshtin franko-gjerman, i cili po kalon ditët e tij më të vështira. Për shkak të qëndrimeve të njëanshme të Kancelarit Scholz në shumë drejtime gjeopolitike, si miratimi i fondit gjerman prej 200 Miliard Euro për të mbuluar pasojat e krizës energjitike, pa asnjë konsultim me Parisin dhe aleatët; kundërshtimin e vendosur ndaj propozimit për krijimin e një tavani/korridor european çmimi të gazit dhe energjisë; kundërshtim i propozimit francez për sovranitet mbrojtës european; qëndrimin tregtar ndaj Kinës pro interesit tregtar dhe jashtë politikës së jashtme të vlerave dhe parimeve, duke i dhënë Portin e Hamburgut konsorciumit kinez "Coscot" dhe aspekte të tjera. Për pasojë, u anulua dhe mbledhja e përbashkët vjetore e dy qeverive.



Në këto rrethana, më 25 Tetor, Macron dhe Scholz drekuan bashkë në Elizée, në përpjek-

je për t'iu dhënë fund këtyre përçarjeve dhe për ta mbajtur në punë" motorrin" e BE-së. Sepse nuk ka alternativë tjetër, sidomos në kushtet e krizave të thella dhe të agresionit rus. Me siguri që do të gjindet zgjidhja, por çështja është se kur dhe me çfarë kosto, jo vetëm për boshtin franko-gjerman, por gjithë BE-në!

5. "Kurbanë" VIP të Brexit në 5 vitet e fundit janë 4 kryeministrit britanikë Cameron, May, Johnson dhe Liz Truss bashkë me dhjetra ministra e qindra zyrtarë të tjerë të lartë të larguar ose dorëhequr. Të katërt artizanë dhe partizanë të zellshëm "BREXIT". Liz Truss theu rekordin me vetëm 55 ditë qeverisje; pasardhësi i saj, Rishi Sunak më shumë po bën bujë për pasurinë e tij më të madhe se vetë Mbreti dhe thirjet për "shtrengim rripi". Në fakt, ndarjet, grindjet dhe përçarjet brenda konservatorëve vazhdojnë.



Fakti është se pas BREXIT britanikët kanë "rënë nga shiu në breshër". Sepse premtimet e bujshme të Brexit nuk zbatohen dot, mbasi mungojnë burimet dhe përfitimet e Brukselit. Gjithsesi, populistët dhe euroskeptikët në Londër nuk duan t'ia dinë për kostot, ata janë gati "të hanë dhe bar por në Bruksel të mos shkelin" Por, shyqyr u kanë ardhur mendtë homologëve të tyre francezë, italianë, gjermanë, etj që nuk duan më "exit" por vetëm „ta marrin nga brenda dhe ta ribëjnë kalanë e Brukselit".

Partneritet strategjik me SHBA-në/ Shqipëria aleat i besueshëm e pikë referimi në rajon



Shqipëria dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës rikonfirmojnë partneritetin strategjik dhe angazhohen për të vijuar bashkëpunimin me interes të përbashkët në fusha si mbrojtja, siguria kibernetike, energjia, transporti apo tregtia.

Kjo ka qenë garancia e dhënë nga ministrja për Evropën dhe Punët e Jashtme, Olta Xhaçka dhe Sekretari Amerikan i Shtetit, Anthony Blinken në përfundim të dialogut të partneritetit strategjik.

Në takimin me dy delegacioneve shqiptare dhe amerikane, Sekretari Blinken u shpreh se SHBA janë krenarë që kanë një aleat të besueshëm si Shqipëria.

Ai vlerësoi bashkëpunimin në të gjitha fushat dhe shprehu gatishmërinë dhe vullnetin e SHBA për ta thelluar bashkëpunimin në energji, biznes e të tjera duke e parë Shqipërinë si një pikë referimi në rajon.

Sekretari Blinken shprehu mirënjohjen e SHBA-së ndaj Shqipërisë, si një aleat që gjithmonë ka marrë përsipër përgjegjësitë e saj. Ai vlerësoi faktin që Shqipëria strehoi shtetasit afganë dhe nënvizoi se

SHBA do të jenë gjithmonë në krah të vendit tonë.

Kryediplomatja Xhaçka falënderoi sekretarin Blinken dhe qeverinë amerikane për mbështetjen dhe bashkëpunimin në mbrojtjen e demokracisë, situatës në Ukrainë, mbrojtjes kibernetike modernizimit të Forcave të Armatosura apo projekteve në zhvillimin në fushën e energjisë.

“Shqipëria e vlerëson shumë partneritetin e saj strategjik me SHBA-të dhe jemi të bindur se kjo marrëdhënie do të thellohet dhe zgjerohet më tej në të ardhmen, duke u bazuar në themelet e qëndrueshme të miqësisë midis vendeve dhe njerëzve tanë”, u shpreh ministrja Xhaçka gjatë takimit me dy delegacionet.

Më 26 Tetor në Departamentin e Shtetit u mbajt, takimi më i rëndësishëm i marrëdhënies politike mes dy vendeve: dialogu i partneritetit strategjik SHBA-Shqipëri. Në dialog morën pjesë përfaqësues nga 6 ministri si dhe nga Departamenti i Shtetit, Departamenti i Mbrojtjes, ai i Tregtisë, Korporata Financiare për Zhvillimin Ndërkombëtar, si dhe agjenci të tjera qeveritare ku u diskutuan rrugë për të thelluar bashkëpunimin strategjik.

Opozita dhe maxhoranca bashkojnë votat pro ndryshimeve në ligjin për dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit

Kuvendi miratoi në mesnaten 20-21 Tetor 2022 projektligjin për ndryshimet në ligjin “Për të Drejtën e Informimit për dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, të ndryshuar.

Kuvendi miratoi me 94 vota pro dhe 1 abstenim projektligjin “Për një ndryshim në ligjin nr.45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, të ndryshuar.

Nisma u ndërmor nga grupi parlamentar socialist në vijim të shkresës së Autoritetit për Informim mbi Dokumentat e ish-Sigurimit të Shtetit drejtuar Kuvendit, lidhur me shqetësimet mbi pastërtinë e figurës së personave të zgjedhur apo të emëruar në detyra shtetërore dhe publike.

Kryetari i grupit parlamentar të PS, Taulant Balla u shpreh se nisma për lustracionin është i nevojshëm dhe se nuk mund të lejohet që ish-bashkëpunëtorët e Sigurimit të Shtetit jenë ende në majën e piramidës së pushtetit. Z. Balla gjatë fjalës së tij parashtrroi një amendament, i cili iu bashkangjiti atij të propozuar përpara seance nga kryetari i grupit parlamentar të PD, Enkelejd Alibeaj, për hapjen e plotë të dosjeve.

